



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2021

V E N D I M

Nr. 95, datë 31/05/2021

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 35, datë 05.03.2021, e znj. M. B., ku pretendohet diskriminim për shkak të “*gjinisë*”, “*gjendjes familjare*”, “*gjendjes martesore*”, “*gjendjes civile*” dhe “*për çdo shkak tjetër*”, nga ana e z. B. B., Prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, rezulton se znj. M.B. është bashkëshortja e ish- oficerit të policisë A. B., i cili ka humbur jetën në datën 30.01.2019, pasi është qëlluar me armë zjarri pranë banesës së tij. Ankuesja sqaron se çështja mbi vrasjen e bashkëshortit të saj, të ndjerë, është ndjekur nga ana e z. B.B., me detyrë Prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili është shprehur me vendim për pushimin e hetimit mbi këtë çështje. Ankuesja pretendon se ka depozituar kallëzim penal pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndaj prokurorit B.B., ku ai akuzohet për shpërdorim detyre.

Znj. M. B. pretendon se nuk ka patur avokat mbrojtës dhe për këtë arsye ka patur kontakte të drejtpërdrejta me prokurorin B. B., i cili sipas saj e ka kërcënuar disa herë brenda ambienteve të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në mënyrë që ajo të heqë dorë nga ndjekja e çështjes së vrasjes së bashkëshortit të saj. Ajo pretendon se ndaj saj është ushtruar dhunë psikologjike dhe z. B.B. ka nxjerrë emrin e saj në median televizive dhe atë të shkruar *on line*, duke shpifur ndaj saj, e duke cënuar integritetin e saj moral. Njëkohësisht, ankuesja pretendon se ka depozituar disa kallëzime penale ndaj tij, ku më të fundit i përkasin datave 15.02.2021 dhe 18.02.2021.

Znj. M.B. pretendon se z. B.B. e ka diskriminuar për shkaqet e sipërcituar, pasi ajo është grua e ve, e pambrojtjur, është pjesë e një familjeje, së cilës i janë vararë tre persona (bashkëshorti i

saj dhe dy vëllezër të tij) dhe është në hasmëri me një tjetër familje. Ajo thekson faktin se diskriminimi i ushtruar ndaj saj konsiston edhe në nxjerrjen e pengesave të pajustificuara, me qëllim bërjen të pamundur të ushtrimit të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara nga Kushtetuta dhe aktet e tjera ndërkombëtare, në të njëjtën mënyrë si individët e tjerë.

Për sa më sipër, ankuesja pretendon se diskriminohet për shkak të “gjinisë”, “gjendjes familjare”, “gjendjes martesore”, “gjendjes civile” dhe “për çdo shkak tjetër”, nga ana e z. B.B., Prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”¹, të ndryshuar, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të “gjinisë”, “gjendjes familjare”, “gjendjes martesore”, “gjendjes civile” dhe “për çdo shkak tjetër”, duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 7, i LMD, të ndryshuar, parashikon shprehimisht: “1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.”

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

Në Kreun III, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Ky ligj në nenin 20, pika 1, të tij parashikon se: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.”*

Hapat procedurialë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 35, datë 05.03.2021, e znj. M. B., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7², të ligjit nr. 10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua z. B.B., prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe për dijeni ankueses dhe Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me shkresën nr. 430/1, datë 19.03.2021, ku kërkohej informacion, si më poshtë vijon:
 1. Informacion i përgjithshëm mbi pretendimet e ankueses;
 2. Kopje e vendimit për pushimin e hetimit mbi vrasjen e z. A. B.;
 3. Informacion nëse vendimi i mësipërm është ankimuar gjyqësisht. Nëse po, të dërgohen kopje të vendimeve të gjykatave respektive;
 4. Kopje të të gjithë kallëzimeve penale të depozituara nga ankuesja në ngarkim të prokurorit B.B., si dhe vendimet përkatëse me të cilat është shprehur organi i prokurorisë;

- Në përgjigje të shkresës nr. 430/1, datë 19.03.2021, së KMD-së, z. B. B., Prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dërgoi pranë KMD-së shkresën nr. 430/2, datë 01.04.2021, nëpërmjet së cilës fillimisht sqaron se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr. 1006, datë 30.01.2019, për veprën penale *“vrasje me paramendim”* dhe *“prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”*, parashikuar nga nenet 78-25 dhe 278/3, të Kodit Penal, në bazë të materialit kallëzues të depozituar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë. Në lidhje

² Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: *“Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.*

me ngjarjen e sipërcituar është marrë nën hetim shtetasi Gj.C., i cili ishte ndaluar nga policia në datën 30.05.2019.

Z. B. B. sqaron gjithashtu se në kushtet kur ai ishte caktuar prokuror i çështjes, ka kërkuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, masën e sigurimit “*arrest në burg*” për shtetasin e sipërpërmendur, masë e cila, është vendosur nga ana e kësaj gjykate.

Personi nën hetim Gj.C. ka kërkuar ndryshimin e masës së sigurimit, por prokurori i çështjes ka kërkuar rrëzimin e kësaj kërkesë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka lënë në fuqi masën e sigurimit “*arrest me burg*” për z. Gj.C. Në vijim, personi nën hetim ka bërë kërkesë pranë kësaj gjykate me objekt- konstatim pavlefshmërie e aktit të ekspertimit biologjik krahasues ADN nr. 5539, datë 30.05.2019. Edhe në lidhur me këtë kërkesë, prokurori B.B. ka kërkuar rrëzimin e saj pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke e cilësuar si të pambështetur në prova dhe në ligj. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesës së personit nën hetim.

Në vijim, z. Gj.C. i është drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë me kërkesat e sipërcituara. Me vendimin nr. 458, datë 21.06.2019, vendimin nr. 990, datë 17.07.2019 dhe vendimin nr. 674, datë 04.09.2019, ndër të tjera gjykata ka vendosur pavlefshmërinë dhe papërdorshmërinë e provave materiale dhe ndryshimin e masës së sigurimit personal nga “*arrest në burg*” në masën “*detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore*” për personin nën hetim Gj. C.

Për sa më sipër, z. B.B. sqaron se në seancat gjyqësore të zhvilluara pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, çështja është përfaqësuar nga prokurorë të Prokurorisë së Apelit Tiranë, pasi është kjo prokurori që përfaqëson kërkesat penale në këtë gjykatë.

Prokurori B.B. thekson faktin se çështja penale nr. 1006/2019 është hetuar nga policia gjyqësore pranë Drejtorisë vendore të Policisë Tiranë, ku në përfundim të hetimeve dhe për mungesë provash është hartuar relacioni përfundimtar, duke sugjeruar pushimin e akuzës në ngarkim të personit nën hetim Gj.C.

Në përfundim të hetimeve, z. B.B. sqaron se ka njoftuar zyrtarisht znj. M.B., duke e njohur atë me përfundimin e hetimeve, si dhe duke i lënë kohën e duhur sipas legjislacionit procedural penal, që ajo të shprehej mbi këtë përfundim. Znj. M.B. ka nënshkruar pa asnjë vërejtje, kundërshtim apo observacion, vendimin për përfundimin e hetimeve.

Nga ana e organit procedues është zbatuar neni 201/a i Kodit të Procedurës Penale (KPP), ku i është marrë deklaratë ADN personit nën hetim, por ky shtetas nuk ka dhënë pëlqim për dhënien e kampionit të ADN-së, në bazë të parashikimit të nenit 201/a të KPP. Për sa më sipër, vendimet e Gjykatës së Apelit Tiranë, janë të formës së prerë dhe i kanë nxjerrë të pavlefshme aktet dhe provat.

Gjykata e Apelit Tiranë ka urdhëruar të rikryhet ekspertimi biologjik vlerësues i ADN-së. Vendimi i është dërguar Institutit të Policisë Shkencorë Tiranë, por në vijim ky institucion e

ka rikthyer vendimin me shkresë, ku është shprehur se nuk mund të rikryhet ekspertimi biologjik i ADN-së së personit nën hetim.

Në përfundim të hetimeve, prokurori i çështjes, z. B.B., i është drejtuar gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë duke i kërkuar pushimin e hetimeve ndaj z. Gj.C., për mungesë provash. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është shprehur me vendimin nr. 1539 akti, datë 11.09.2020, ku ka vendosur pranimin e kërkesës së organit të prokurorisë, pushimin e hetimeve në ngarkim të personit nën hetim Gj.C., për veprën penale të vrasjes me paramendim të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 78/2, 278/e-25 të Kodit Penal, si dhe heqjen e masës së sigurimit personal “*detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore*” të personit nën hetim.

Ky vendim është ankimuar nga znj. M.B., duke bërë thjesht një kërkesë për zënie afati, pa parashtruar argumente se përse e kundërshton. Çështja ndodhet për gjykim pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

Lidhur me pretendimin e ankueses se ajo nuk ka patur avokate në këtë proces, z. B.B. shpreht se kjo ka qenë zgjedhje e saj, duke e cilësuar person madhor që gëzon zotësi të plotë për të vepruar dhe ka arsim të lartë e punon si punonjëse policie. Ai sqaron se komunikimi i tij, në cilësinë e prokurorit, me znj. M.B., në cilësinë e viktimës ka qenë korrekt. Ai shprehet se i është përgjigjur kërkesave të saj për takim, në rastet kur ajo ka kërkuar të tilla. Të gjitha takimet janë zhvilluar në zyrë, në prani të tre kolegëve të zyrës, B.M., D.M. dhe Sh.K.

Prokurori B.B. thekson faktin se pretendimi i ankueses, se ai e ka kërcënuar dhe ka ushtruar dhunë psikologjike, që ajo të heqë dorë nga ndjekja e çështjes së bashkëshortit, nuk është aspak e vërtetë. Përkundrazi, znj. M.B. në mënyrë të përsëritur dhe në ambiente publike ka ndërmarrë veprime konkrete duke e ofenduar, kërcënuar deri në vrasje, por ai pretendon se nuk ka reaguar. Rasti më flagrant ka qenë në datën 21.01.2021, në ambientet e lokal “Gloe”, pranë Shkollës “Harry Fultz”. Ky rast është referuar nga ana e prokurorit B.B. në të gjithë hallkat e Policisë së Shtetit dhe në institucionit përkatëse. Për këtë rast, ai e ka kallëzuar penalisht ankuesen, pasi ajo i përshkallëzoi veprimet ndaj tij. Këto raste, janë duke u hetuar nga strukturat e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Policinë e Shtetit dhe nga organi i prokurorisë.

Z. B.B. sqaron se znj. M.B. ka depozituar 6 kallëzime penale ndaj tij, pranë SPAK, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe Tiranë. Në të gjitha rastet, këto institucione kanë vendosur mosfillim të çështjes, si të pabazuar në ligj. Znj. M. B. i ka ankimuar këto vendime dhe përsëri nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë janë rrëzuar si të pabazuara në prova dhe ligj.

Prokurori B.B. shprehet se pretendimet e znj. M.B. janë tërësisht të pavërteta dhe shpreh gatishmërinë e tij për t’u ballafaquar me të pranë institucionit të Komisionerit.

Për sa më sipër, Komisioneri do të shprehet në këtë vendim vetëm për ato çështje, për të cilat LMD i atribuon tagra dhe kompetenca për t'i shqyrtuar.

- Në vijim të procedurave hetimore, Komisioneri i dërgoi znj. M.B., me e-mail, një kopje të shkresës nr. 430/2, datë 01.04.2021, së z. B.B., duke i kërkuar edhe kundërshtimet e saj me shkrim. Ankueses iu kërkuan dhe kopje të kallëzimeve penale kundër prokurorit, si dhe vendimeve të prokurorive, që kishin shqyrtuar këto kallëzime etj.

Znj. M.B. dërgoi parashtrimet e saj me shkrim duke theksuar dhe duke u ndalur hollësisht tek shkeljet e kryera nga z. B.B., gjatë hetimit të çështjes së vrasjes së bashkëshorti të saj, duke e akuzuar për shpërdorim detyre, kanosje e dhunë psikologjike.

C. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

1. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankuesit.

Në ankesën e znj. M.B. pretendohet diskriminim për shkak të “*gjinisë*”, “*gjendjes familjare*”, “*gjendjes martesore*”, “*gjendjes civile*” dhe “*për çdo shkak tjetër*”, nga ana e z. B.B., Prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në këtë ankesë, ankuesja ngre disa pretendime ndaj z. B.B., të cilat analizohen si më poshtë vijon:

➤ Pretendimi i parë i ankueses kundër z. B.B., Prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Znj. M.B. është bashkëshortja e shtetasit A. B., i cili është vlarë me armë zjarri, në datën 30.01.2019. Për këtë çështje është regjistruar një procedim penal, ku është hetuar në lidhje me vrasjen e bashkëshortit të saj. Në këtë çështje ka patur një person të dyshuar për kryerjen e veprës penale, i cili ka qenë z. Gj.C. Çështja hetimore ndaj këtij të dyshuari është ndjekur nga z. B.B., Prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ankuesja pretendon se z. B.B. ka shpërdoruar detyrën gjatë hetimit të çështjes dhe në përfundim të hetimeve i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë duke i kërkuar pushimin e hetimeve ndaj z. Gj. C., për mungesë provash. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është shprehur me vendimin nr. 1539 akti, datë 11.09.2020, ku ka vendosur pranimin e kërkesës së organit të prokurorisë, pushimin e hetimeve në ngarkim të personit nën hetim Gj.C., për veprën penale të vrasjes me paramendim të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 78/2, 278/e-25 të Kodit Penal, si dhe heqjen e masës së sigurimit personal “*detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore*” të personit nën hetim.

Ankuesja e ka kundërshtuar vendimin e sipërcituar dhe çështja është duke u gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

Nga dokumentacioni i administruar në cilësi prove nga të dy palët rezulton se ankuesja ka depozituar disa kallëzime penale kundër prokurorit B.B., por edhe ndaj personave të tjerë zyrtarë, të cilët ajo i konsideron të involvuar në këtë çështje, për kryerjen e veprës penale të shpërdorimit të detyrës, të parashikuar nga neni 248, i Kodit Penal, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pranë SPAK. Këto institucione janë shprehur me vendime për mosfillimin e procedimeve penale. Ankuesja i ka kundërshtuar këto vendime pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, por kërkesat e saj janë rrëzuar nga gjykata.

Ankuesja pretendon kryerjen e shkeljeve ligjore nga ana e prokurorit B.B. gjatë kryerjes së veprimeve hetimore, fakte të cilat i kallëzuar penalisht, por edhe ua ka bërë të ditur organeve të rëndësishme të drejtësisë³, nga të cilat ajo pretendon se nuk ka marrë zgjidhje. Në këtë kontekst, ankuesja kërkon që Komisioneri të kryejë hetimin e tij, për të konstatuar diskriminimin e saj, për shkaqet e sipërcituara, nga ana e z. B.B., si pasojë e veprimeve të paligjshme të kryera nga ana e tij.

Në nenin 33, pika 4, gërma b), të LMD, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht : *“Ankesa nuk pranohet ku.....b) “përbën abuzim me të drejtën e ankimit para komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji”*

Në rastin konkret, Komisioneri gjykon se pretendimet e znj. M.B., e kalojnë kufirin administrativ të trajtimit të ankesës, pasi konsistojnë në pretendime/akuza për kryerjen e veprave penale nga ana e prokurorit B.B., gjatë kryerjes së detyrës, pra në rastin konkret gjatë kryerjes së procedurave hetimore të një çështjeje penale. Qendrimi i padrejtë dhe disfavorizues ndaj të cilit ankuesja pretendon se është ekspozuar, mund të vërtetohet vetëm nëse shkeljet e pretenduara të z. B.B. do të “vuloseshin” si të tilla, pas një hetimi penal nga ana e Prokurorisë dhe në vijim me vendim gjykate të formës së prerë. Në këtë kontekst, Komisioneri thekson faktin se nuk ka tagër hetimin e veprave penale. Kjo është kompetencë ligjore e organit të prokurorisë, e cila është shprehur me disa vendime për mosfillim të procedimeve penale ndaj kallëzimeve penale të znj. M.B. kundër z. B.B..

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se çështja e parashtruar nga ana e znj. M.B. është jashtë tagrave, që Komisionerit i atribuohen nga LMD, i ndryshuar. Për këtë arsye, ky pretendim nuk mund të pranohet për shqyrtim, pasi është i papajtueshëm me dispozitat e këtij ligji.

³ Në tërësinë e ankesave të paraqitura pranë institucioneve ligjvënëse, përfshihet edhe ankesa nr. 1579, datë 26.02.2021, e znj. M.B. drejtuar Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë, nga ku i është kthyer përgjigje nëpërmjet shkresës nr. 1579/3, datë 23.03.2021, ku ajo njoftohet për vendimin e arkivimit të ankesës pas shqyrtimit fillestar, pasi ankesa nuk i plotëson kushtet e pranueshmërisë.

➤ **Pretendimi i dytë i ankueses M.B.kundër z. B.B., Prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.**

Përveç sa më sipër, znj. M. B. pretendon se prokurori B.B., i cili ka ndjekur hetimin e çështjes, lidhur me vrasjen e bashkëshortit të saj, i ka bërë presione, kanosje dhe ka ushtruar dhunë psikologjike ndaj saj, në mënyrë që ajo të mos vazhdojë të ndjekë më këtë çështje dhe të zbardhë të vërtetën mbi humbjen e jetës së të ndjerit A. B. Ankuesja pretendon se diskriminohet në formën e shqetësimit, për shkaqet e sipërcituara, nga z. B.B..

Neni 3, pika 13, i LMD, të ndryshuar, parashikon shprehimisht: *“Shqetësim” është ajo formë diskriminimi që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, kur lidhet me cilëndo nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, që ka për qëllim ose efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqtësor, përçmues, poshtërues a ofendues për atë person, si dhe trajtimi më pak i favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cënuar ndaj një sjelljeje të tillë.”*

Nga dokumentacioni i depozituar në cilësi prove rezulton se përveç veprës penale të shpërdorimit të detyrës, nëpërmjet kallëzimit penal të datës 23.01.2021, depozituar pranë Komisarariatit të Policisë Nr. 3, kundër Prokurorit B.B., ankuesja e ka akuzuar prokurorin edhe për kanosje, dhunë psikologjike etj., por edhe për këtë çështje, me vendim të prokurorisë, është vendosur mosfillimi i procedimit penal kundër z. B.B..

Ndërkohë që, edhe prokurori B.B. e ka kallëzuar penalisht ankuesen për veprat penale të “kanosjes” dhe “përndjekjes”, të parashikuar nga nenet 84 dhe 121/a e Kodit Penal, çështje e cila është ende nën hetim nga strukturat përkatëse.

Lidhur me këtë pretendim të ankueses, Komisioneri gjykon se gjatë hetimit administrativ të tij, nuk janë administruar prova dhe fakte konkrete, përveçse ato verbale nga të dy palët. Njëkohësisht, mbështetur në vendimet e mosfillimit të procedimit penal të dhëna nga prokuroritë respektive, lidhur me akuzat e znj. Bilali për kanosje e presione, e dhunë psikologjike, bëjnë që pretendimet kundër e z. B.B. të rezultojnë të paprovuara.

Për sa më sipër, mbështetur në nenin 14 *“Parimi i objektivitetit”*, i Kodit të Procedurave Administrative, ku parashikohet shprehimisht: *“Gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative, organet publike marrin në konsideratë dhe i japin rëndësinë e duhur të gjitha kushteve, të dhënave dhe provave që lidhen me procedurën administrative.”*, Komisioneri gjykon se në mungesë të provave konkrete, nuk provohet pretendimi i ankueses.

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se ankuesja nuk është ekspozuar ndaj një qendrimi të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë. Në mungesë të tij, nuk ekziston diskriminim për shkaqet e pretenduara në ankesë.

➤ **Pretendimi i tretë i ankueses kundër z. B.B., Prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.**

Ankuesja M.B.pretendon se emri i saj është nxjerrë nga ana e prokurorit B.B. në media, pasi ai e akuzon për veprime, që ajo nuk i ka kryer. Z. B.B. ka nxjerrë emrin e saj në median televizive dhe atë të shkruar *on line*, duke shpifur ndaj saj, e duke cënuar integritetin e saj, moral.

Referuar hetimeve të kryera nga Komisioneri rezulton se në faqen zyrtare on line të Top Channel gjendet artikulli me titull: *“Bashkëshortja e të ndjerit kërcënon me jetë prokurorin e çështjes për vrasjen e A. B.! B.B. për TCH: Është hera e tretë që ndodh!”* Përmbajtja e artikullit konsiston si vijon: *“Gazetarja e Top Channel, A. H., raporton se ngjarja e paprecedentë ka ndodhur dje në orët e pasdites. Mësohet se Prokurori ishte i ulur në një lokal përball shkollës ‘Harry Fultz’ në momentin që është kërcënuar. Po ashtu është zbuluar edhe identiteti i kërcënueses e cila është një grua me inicialet, M.B. Kjo e fundit mban detyrën e oficeres së Policisë dhe është gruaja e të ndjerit A. B. Prokurori që është kërcënuar ka hetuar vrasjen e bashkëshortit të saj, A. B. I dyshuar i kësaj vrasje ka qenë Gj. C., ku ndonëse prokurori e ka arrestuar për ngjarjen, Gjykata e Apelit i ka dhënë lirinë. Gruaja e viktimës Bilali edhe pse vendimin e ka dhënë Gjykata e Apelit dhe ka liruar Gj. C., e kërcënon për herë të tretë Prokurorin e çështjes. I kontaktuar nga gazetarja e Top Channel, A. H., Prokurori B.B. tha: “Kam njoftuar drejtuesit e policisë së shtetit A. V., dhe zyrtarë të tjerë në lidhje me ngjarjen e ndodhur dhe pres prej tyre reagim ligjor. U kërcënova për shkak të detyrës dhe kjo është hera e tretë, për një çështje për të cilën vendimarrja ka qenë tërësisht e gjykatës.”.....”*

Edhe në disa faqe të tjera on line janë botuar artikuj lidhur ngjarjen e sipërcituar. Në faqen e **Fast News** citohet titulli i artikullit të datës 22.01.2021, i gazetares A.S.: *“Kërcënohet me vdekje Prokurori i Tiranës, gruaja e policit të vrarë A. B. hyn në lokalin, ku ai qëndronte dhe...”*. Në përmbajtjen e këtij artikulli rezulton se: *“Prokurori i rrethit gjyqësor Tiranë, B.B. është kërcënuar me vdekje. Sipas informacioneve për mediat, B. B. është ulur përballë shkollës ‘Harry Fultz’ në momentin që është kërcënuar nga M. B., e cila mban detyrën e oficeres së Policisë dhe është gruaja e të ndjerit A. B. Prokurori B.B. ka hetuar vrasjen e bashkëshortit të saj, A. B. dhe i dyshuari i vrasjes ka qenë Gj. C., i njohur ndryshe si “i forti i Myslym Shyrit”. Pavarësisht se prokurori ka dhënë urdhër për arrestimin e tij, Gjykata e Apelit e ka liruar. B. B. është kërcënuar për herë të tretë nga gruaja e viktimës, A. B. “Kam njoftuar drejtuesit e policisë së shtetit A. V., dhe zyrtarë të tjerë në lidhje me ngjarjen e ndodhur dhe pres prej tyre reagim ligjor. U kërcënova për shkak të detyrës dhe kjo është hera e tretë, për një çështje për të cilën vendimarrja ka qenë tërësisht e gjykatës”,- ka thënë prokurori B.B. për mediat.....”*

Tek faqja on line AZ Lajme sërisht gjen vend artikulli i datës 22/01/2021, me titull “Nuk hetoi vrasësit e bashkëshortit”, efektivja e Policisë kërcënon prokurorin: Do të vras! Në thelb, përmbajtja e tij është pothuajse e njëjtë me atë të artikullit të sipërcituar.

Në shkresën e tij, drejtuar Komisionerit, z. B.B. ka theksuar faktin se znj. Bilali në mënyrë të përsëritur dhe në ambiente publike ka ndërmarrë veprime konkrete duke e ofenduar, kërcënuar deri në vrasje, por ai pretendon se nuk ka reaguar. Rasti më flagrant ka qenë në datën 21.01.2021, në ambientet e lokal “Gloe”, pranë Shkollës “Harry Fultz”. Ky rast është referuar nga ana e prokurorit B.B. në të gjithë hallkat e Policisë së Shtetit dhe në institucionin përkatës. Për këtë rast, ai e ka kallëzuar penalisht ankuesen, pasi sikurse citohet në shkresën zyrtare të tij drejtuar KMD-së, ajo i ka përshkallëzuar veprimet ndaj tij. Këto raste, janë duke u hetuar nga strukturat e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Policinë e Shtetit dhe nga organi i prokurorisë.

Në këtë kontekst, Komisioneri sqaron se hetimi administrativ i pretendimit të znj. M. B. ka lidhje me parashikimin e nenit 3, pika 13, të LMD, të ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht: “*“Shqetësim” është ajo formë diskriminimi që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, kur lidhet me cilëndo nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, që ka për qëllim ose efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues a ofendues për atë person, si dhe trajtimi më pak i favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cenuar ndaj një sjelljeje të tillë.”*

Për sa më sipër, Komisioneri vë në dukje faktin se në rastin konkret, në artikujt e publikuar më sipër, është kryer një paraqitje e fakteve lidhur me ngjarjen e ndodhur në datën 21.01.2021, sipas versionit të prokurorit B. B., nga gazetarët përkatës. Publikimi i artikujve nuk është kryer nga subjekti kundër së cilit drejtohet ankimi, por nga gazetarë të ndryshëm, të cilët kanë cituar dhe interpretuar prokurorin B. B. Në rastin konkret, Komisioneri gjykon se nuk kemi të bëjmë me parashikimin e sipërcituar për shqetësim nga ana e z. B. B.

Gjithashtu, Komisioneri gjykon se vërtetësia e këtij “versioni” është duke u hetuar nga organet kompetente, pasi z. B. B. ka depozituar kallëzim penal, lidhur me ngjarjen e ndodhur, në datën 21.01.2021.

Për sa më sipër, Komisioneri çmon se nuk vërtetohet një trajtim i padrejtë, disfavorizues e i pabarabartë i ankueses nga prokurori B.B.. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se ankuesja nuk është ekspozuar ndaj një qendrimi të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë. Në mungesë të tij, nuk ekziston diskriminim për shkaqet e pretenduara në ankesë.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 1, nenin 3, pika 13, nenin 7, pika 1, nenin 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pika 4, gërma b) dhe pikat 9-10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës nr. 35, datë 05.03.2021, së znj. M. B., mbi pretendimin e shpërdorimit të detyrës nga ana e prokurorit B.B., gjatë hetimit të çështjes së vrasjes së bashkëshortit të saj, pasi kjo çështje është e papajtueshme me dispozitat e ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.
2. Konstatimin e mosdiskriminimit, në formën e shqetësimit - presion dhe dhunë psikologjike, për shkak të “*gjinisë*”, “*gjendjes familjare*”, “*gjendjes martesore*”, “*gjendjes civile*” dhe “*për çdo shkak tjetër*”, së znj. M.B. nga ana e z. B.B., Prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
3. Konstatimin e mosdiskriminimit, në formën e shqetësimit, për shkak të “*gjinisë*”, “*gjendjes familjare*”, “*gjendjes martesore*”, “*gjendjes civile*” dhe “*për çdo shkak tjetër*”, nga ana e z. B.B., Prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë ndaj znj. M. B., si rrjedhim i artikujve të publikuar në media, lidhur me ngjarjen e datës 21.01.2021, në ambientet e lokal “Gloe”, pranë Shkollës “Harry Fultz”.
4. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha – Të mira dhe shërbime

Shkak - “*gjinia*”, “*gjendja familjare*”, “*gjendja martesore*”, “*gjendja civile*” dhe “*për çdo shkak tjetër*”

Lloji i vendimit - Mosdiskriminim